



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr.229, Datë 12.09.2022

MBI

PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN GUSHT 2022 PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 KV DHE ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR PERIUDHËN 01.08.2022 – 31.12.2022 PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 20/10/6 KV

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar; dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.09.2022, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1528/3 prot., datë 09.09.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin gusht 2022 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kv dhe çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për periudhën 01.08.2022 – 31.12.2022 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 KV”,

Konstatohet se:

- Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a. me shkresën nr. 6093 prot., datë 06.09.2022, protokolluar me tonën me nr. 1441/1 prot., datë 08.09.2022, ka paraqitur aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike prej 31,37 lekë/kWh për muajin Gusht 2022, ku janë përfshirë edhe kostot e disbalancave, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF).
- Shoqëria FSHU sh.a. me shkresën nr. 6084 prot., datë 06.09.2022, protokolluar me tonën me nr. 1441/2 prot., datë 08.09.2022, ka paraqitur aplikimin për miratimin e çmimit të energjisë

elektrike prej 18,34 lekë/kWh për muajin Gusht 2022, ku janë përfshirë edhe kostot e disbalancave, për klientet e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, të cilët kanë dalë në treg të parregulluar nga data 1 Janar 2022 dhe aktualisht furnizohen nga FMF.

- Mbështetur në nenin 6, pika 3 dhe pika 5 të “Metodologjise së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar: tarifa që FMF do të aplikojë/ngarkojë te klientët, do të përfshijë kostot për blerjen e energjisë elektrike për këta klientë për periudhën e lëvrimit, mbi të cilën do të aplikohet dhe një marzh i furnizimit i cili vendoset nga Rregullatori. Kostot e disbalancave do të llogariten dhe faturohen nga shoqëria, në përputhje me përcaktimet e Rregullave të Tregut të Balancimit dhe akteve të tjera në fuqi.
- Në lidhje me komponentët e tjerë të përlllogaritjes së çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët FMF për muajin Gusht 2022 evidentojmë se në përputhje me nenin 9 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” e ndryshuar, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga FMF për muajin Gusht 2022 janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike.
- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” e ndryshuar, llogaritjet e FSHU sh.a. si dhe përlllogaritjet e ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga FMF për muajin Gusht 2022, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:

<i>Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për nivele tensioni për muajin Korrik 2022</i>				
KORRIK 2022		Nivelet e tensionit		
		35 kV	20/10/6 kV	
	Njësia	Çmimi	Çmimi	
CBEt	ruar i blerjes së energjisë elektrike	Leke/kWh	26.93	12.00
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.81	0.36
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.06	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.85	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.55	3.99
Çmimi i energjisë = CBEt +Pr* CBEt+ TRr+TSHt+CA		Leke/kWh	31.20	18.26

- Elementët përlllogaritës të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga FMF mbeten të pandryshuar prej disa muajsh, ERE me shkresën nr. 1514 prot., datë 02.09.2022, ka kërkuar informacion nga shoqëritë KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. nëse çmimi i shitjes do të vijojë të mbetet i pandryshuar prej 12 lekë/kWh, si parashikuar në Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme së shoqërisë KESH sh.a. Duke qënë se nuk ka njoftim nga shoqëritë KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. për ndryshim të çmimit prej 12 lekë/kWh për klientët e lidhur në nivel tensioni 20/10/6 kV, vlerësohet të vijohet me llogaritjet për periudhën e mbetur të vitit 2022.

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse dhe në të dhënat e paraqitura në aplikime, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga FMF do të jetë:
 - *31.29 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin Gusht 2022;*
 - *18.26 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV për periudhën 01.08.2022 – 31.12.2022.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Gusht 2022, prej 31.29 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV;
2. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për periudhën 01.08.2022 – 31.12.2022, prej 18.26 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV.
3. Çdo ndryshim në elementët përbërës të çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, të miratuar në pikën 2 të këtij vendimi, për periudhën pas hyrjes në fuqi përbën shkak për rishikimin e këtij vendimi.
4. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI